



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 77/12
Prishtinë, më 11.09.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Omani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu dhe Albulena Gashi(praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Alexander Beetz, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit dt. 28.08.2012, dhe 29.08.2012;**
3. **Caktimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë;**
4. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur të komisionit dt. 28.08.2012, dhe 29.08.2012**

Muhamet Mustafa pyeti a bëhen transkriptet për mbledhjet e Komisionit. Propozimi im është që ne të kërkojmë që në rregullore të parashihet që të bëhen transkriptet edhe për mbledhjet e komisionit.

Kryetarja sqaroi se në Rregulloren e Kuvendit nuk është paraparë që të mbahen transkriptet për mbledhjet e komisioneve dhe në mbajmë vetëm procesverbalin, me përjashtim dëgjimeve publike që mbahet transkript. Nëse mendoni se ka humbur esenca diskutimit mund të kërkonti të bëhen përmisimet, janë edhe inxhizimet e mbledhjes që mbahen nga administrata dhe mund të verifikohet.

Muhamet Mustafa kërkoi që në procesverbalin e dt. 28.08.2012, në pikën kur është diskutuar për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Letërnjoftimin në diskutimin e tij, të përmisohet fjalia e parë dhe të thuhet duhet të kaloj ligji në lexim të dytë dhe jo të mbetet nuk duhet të kalojë ligji, sepse ky ka qenë mendimi i shprehur i imi.

Kryetarja konstatoi se procesverbalet miratohet me vërejtjen e ngritur nga deputetit Muhamet Mustafa e cila duhet të korrigjohet.

3. Caktimi i grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Kryetarja si komision funksional kemi rekomanduar që projektligji të miratohet në seancë plenare në parim, për çka edhe në Seancën e fundit Plenare është miratuar në parim nga Kuvendi. Ju e dini që nevoja për plotësimet dhe ndryshimet e këtij projektligji kanë ardhur si rrjedhojë e miratimit të ligjit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare. Ne si komisioni funksional tani duhet të vazhdojmë punën në shqyrtimin dhe amendamentimin e tij. Prandaj sot duhet të caktojmë grupin punues që do të shqyrton më në detale dhe do të përgatit raportin me amendamente brenda afatit të paraparë.

Hykmete Bajrami kërkoi të sqarohemi se a kemi të drejtë të ndërhyjmë në ligj a po vetëm në projektligj. Ka pasur raste që në disa ligje është ndërhyrë e në disa jo dhe ka opinione të ndryshme për këtë çështje. Më kujtohet që një projektligj u kthye nga seancë për këtë qëllim dhe ka kaluar me ndryshimet me ndërhyrjet që kanë qenë në ligj.

Kryetarja theksoi se ne kemi kërkuar interpretim nga departamenti ligjor i kuvendit dhe kemi marrë përgjigjen me shkrim të cilën e kemi pas të gjithë deputetët besoj që e kemi lexuar e kemi shiku se çka është thënë. Por Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar se nuk bënë me ndërhyrje në ligjin bazë.

Sali Asllani unë mendoj se nëse në ligj vetëm një presje nëse e ndryshon ke ndërhyrje komplet në ligj, interpretimi i rregullores mundet me qenë i tillë por qo neve po logjika hiq nuk e rrokë.

Hykmete Bajrami një çështje tjetër ka të bëjë me miratimin e projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese, dhe mbetjen e tyre si dokumente të veçanta dhe kështu po i kemi disa dokumentet që kanë që kanë të bëjnë me një ligj të caktuar. Mendojë që duhet trajtuar seriozisht kjo çështje dhe të shkon si kërkesë në kryesinë e kuvendit a po të ngritet si çështje në seancë plenare. Është e rëndësishëm që ligji i ri që miratohet që e ndryshon dhe plotëson ligjin bazik, të inkorporohen në të atë ligj dhe mos të kemi disa dokumente për të njëjtë çështje. Kjo është problem edhe për qytetarët të cilët nëse iu intereson një ligj, mund ta kërkojnë në gazetë zyrtare dhe ndoshta ai ligj ka ndryshue dy apo tri herë dhe ai nuk është i informuar se gjinden disa dokumente të veçanta sepse nuk është e sqaruar mirë kjo çështje. Si institucion ligjvënës që jemi duhet të vejmë disa rregulla dhe ti bëjmë disa punë më praktike dhe pragmatike.

Kryetarja theksoi kemi diskutu për këtë çështje dhe është ngrit disa herë në mandatin tjetër sepse po ndodhin ndryshime të shpeshta të ligjit dhe po kemi disa dokumente për të njëjtën çështje. Mirëpo kjo nuk

është në mandatin tonë si komision të merrem me çështje, por ne mundemi me ngrit si shqetësim si deputetë në seancën plenare.

Latif Gashi për sa kam informacione në çdo vend, mbetet ligji i vjetër dhe ligji i ri dhe kjo është mirë dhe duhet të jetë në histori në arhivë se si ka qenë dhe çfarë është ndryshuar dhe kjo çështje i përket komisionit për legjislacion. Për sa kam shfletuar unë edhe në Shqipëri e ke çdo ligj në arkiv, përfshirë edhe plotësimet dhe ndryshimet e ligjeve.

Kryetarja propozoi që në grupin punues të jenë këta anëtar: Naser Osmani (Kryesues), Latif Gashi Jelena Bontic edhe Albana Fetoshi.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri caktoi grupin punues: Naser Osmani (Kryesues), Latif Gashi, Jelena Bontic edhe Albana Fetoshi.

4. Të ndryshme

4.1. Kryetarja sqaroi se grupi punues për mbikëqyerjen e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. GIZ ka angazhuar dy ekspertë që të merren me analizën e detale të ligjit. Është hartuar draftplani i veprimit dhe ka mbetur të finalizojmë institucionet dhe agjencionet që do të vizitojmë. Grupi punues të merret seriozisht me monitorim, por edhe të gjithë anëtarët e komisionit mund të marrin pjesë dhe të kontribuojnë dhe t'iu bashkëngjitet grupit punues. Për vizitat dhe takimet që do të mbahen do të njoftoheni nga stafi i komisionit. Propozojë që Komisioni për Buxhet dhe Financa, ti drejtohet më kërkesë Komisionit për Mbikëqyerjen e Zbatimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike për caktimin e dy anëtarëve për t'iu bashkangjitur grupit punues në mbikëqyerjen e zbatimit të LMFP.

Propozimi për t'iu drejtuar me kërkesë KMFPP për caktimin e dy anëtarëve për t'iu bashkangjitur grupit punues në mbikëqyerjen e zbatimit të LMFP, u përkrah njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

Muhamet Mustafa theksoi se ky me të vërtetë është një ligj i mirë organik dhe ligji më i rëndësishëm mas kushtetutës. Puna jonë me monitorimin e zbatimin e ligjit të orientohet në propozimet eventuale për përsosjen e këtij ligji.

Kryetarja unë mendoj se është ligj i mirë edhe shumë ligj i rëndësishëm e për menaxhimin e financave publike është si një lloj kushtetute për financat publike, megjithatë për neve në komision është me më rëndësi të dijmë se a po zbatohet në praktik ky ligj. Për mbikëqyerjen e këtij ligjit kemi vendosur me rastin e miratimit të planit vjetor të punës.

4.2. Kryetarja njoftoi se e kemi një kërkesë nga Fondi i Kursimeve Pensionale për aprovimin e taksës menaxhuese që thirren në ligjin e ri. Këtë kërkesë e kemi pasur pikë të rendit të ditës edhe në një takim të komisionit para pushimit dhe e kemi shtyer për të kërkuar sqarime shtesë. Dje unë dhe zëvendëskryetari i komisionit e kemi zhvilluar një takim me përfaqësuesit e fondit për këtë çështje. Mendojë që duhet të trajtojmë në një mbledhje të tjetër të komisionit, ku do ti merrni të gjithë materialet lidhur me këtë çështjet si dhe pjesën e ligjit që flet për caktimin e taksës menaxhuese, sepse edhe vet ligji nuk e ka përcaktuar qartë çështjen e caktimit të taksës menaxhuese.

Mbledhja përfundoi: 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj